



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.2.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË
FINANCIVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Besa Morina (Udhëheqës e ekipe) dhe Shqiponja Krasniqi/Veton Misiri dhe Bekim Mikullovc (Anëtarë e ekipe), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Emine Fazliu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	25
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	28
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	30

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Financave për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 21.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Financave.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj te fakti se:

- Shpenzimet e anëtarësisë në vlerë prej 716,500€ ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Për më gjerësisht shih pjesën 1.1 të këtij raporti.


Ky opinion jepet vetëm për Ministrinë e Financave, duke përjashtuar Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, për të cilat ne kryejmë auditime të veçanta si dhe përgatisim raporte individuale për to, përfshirë edhe opinionet e auditimit.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij mbështetës për bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Ministrit

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë së Financave (MF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet në vlerë prej 716,500€, për anëtarësim të Republikës së Kosovës në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës (BZHKE) janë buxhetuar dhe paguar gabimisht nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve. Nga përmbajtja e kësaj marrëveshjeje këto shpenzime do të duhej të paguhen nga kategoria ekonomike pagesat tjera.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë Financave është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Financave është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Financave (MF) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me rregullën financiare nr.01/2013, dhe rreg.financiare nr.02/2013;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet e kontratave të nënshkruara të prokurimit;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Raporti vjetor i performancës.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime për të cilat kemi dhënë sugjerime për t'i përmirësuar ato. Pas sugjerimeve tona, MF kishte korrigjuar PFV-të në pikat si në vijim:

- *Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit - te shënimet 9 dhe 10 - nuk ishin prezantuar të hyrat tatimore dhe jo tatimore sipas formatit që kërkon rregulla nr.01/2017 për Pasqyra Financiare Vjetore; dhe*
- *Te neni 14 - shënimi 14 - Tjera /Depozita, kolona C ishte prezantuar depozita në vlerë prej 262,950€, përderisa do duhej të prezantohej vlera 119,002€ që paraqet pagat në mirëbesim (Ilogari që operon Thesari), po ashtu edhe te neni 13 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - shënimi 8, Pagesa tjera - është prezantuar gjendja e njëjtë.*

Edhe pas këtyre përmirësimeve pas shqyrtimit të kategorive përkatëse kemi vërejtur se PFV-të përmbanin disa gabime të cilat i kemi shpalosur në theksimin e çështjes te opinioni i auditimit.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur me lartë ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se ka marrë masat dhe veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të hapet një kod i ri ekonomik - Pagesat për investime në kapital aksionar/ekuitet me rastin e anëtarësimit ne Institucione Ndërkombëtare Financiare. Më pas në përputhje me standardet e kontabilitetit të sektorit publik buxhetimi, shpenzimi dhe raportimi duhet të bëhen në kuadër të këtij kodi. Përgatitja e PFV-ve për vitin 2017 duhet të përfshijë një rishikim të hollësishëm të draft pasqyrave nga menaxhmenti, dhe vetëm pas sigurimit të kontroleve në rishikimin e PVF-ve, mund të nënshkruhet dhe dorëzohet deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MF-in që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne vlerësojmë progresin e bërë të MF-it sa i përket raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe përgatitjes së raportit për menaxhimin e rrezikut. Po ashtu niveli i zbatimit të gjysmës së rekomandimeve të vitit paraprak, është një tregues i përpjekjeve për zhvillimin e mëtutjeshëm të proceseve nga ana e menaxhmentit të MF-së.

MF kishte formuar grupin koordinues për koordinim dhe monitorim të zbatimit të Strategjisë 2016-2020 si dhe Planin e Veprimit për 2017. Gjithashtu Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme, për të cilat kishte dhënë edhe rekomandime për përmirësim.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar në tetë (8) rekomandime kryesore. Ministria e Financave kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, pesë (5) rekomandime janë zbatuar plotësisht dhe tri (3) ishin zbatuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III. Ky raport është diskutuar edhe në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Pavarësisht përgatitjes së planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe angazhimit të MF-së për t'i zbatuar ato, një pjesë e rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara plotësisht.

Mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve ka ndikuar që disa mangësi të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo ishte evidente te menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe te procesi i prokurimit.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se janë analizuar shkaktarët e mos zbatimit të plotë të rekomandimeve, si dhe të përcaktoj një afat të ri kohor për zbatimin e tyre, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Ky plan duhet të monitorohet në vazhdimësi.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MF më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara konstatoam se:

- Lista e vet-vlerësimit ishte plotësuar nga MF, ku ishte paraqitur gjendja e saktë e organizatës dhe ishte përcjelle me dëshmitë përkatëse;
- MF-i kishte hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të institucionit për vitet 2016-2020, përfshirë edhe koston financiare e cila pritet të miratohet. Në fund të vitit ministri përmes një vendimi kishte themeluar një grup koordinues me qëllim të koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të strategjisë 2016-2020 si dhe planit të veprimit për vitin 2017; si dhe
- Në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuar, MF kishte hartuar planin për menaxhimin e rreziqeve si dhe planin për monitorimin e rreziqeve.

2.2.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Në kuadër të MF-së funksionojnë agjencitë ekzekutive, si: Dogana e Kosovës (DK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF). Agjencitë ekzekutive përgatisin pasqyra financiare, të cilat konsolidohen në PFV- të e MF-së. Procesi i konsolidimit të raporteve financiare funksionon mirë, megjithatë duhet një bashkëpunim më i madh ndërmjet agjencive në mënyrë që cilësia e PFV-ve të konsoliduara të jetë në nivel edhe me të lartë. Agjencitë kanë strukturën e vet menaxheriale, përmes të cilës organizohet menaxhimi i aktiviteteve të përditshme operative.

Menaxhimi dhe funksionimi i të gjitha aktiviteteve në DK dhe në ATK do të trajtohen në raporte individuale të auditimit të kryera nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Bazuar në kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Agjencitë e pavarura të cilat raportojnë në Kuvendin e Kosovës e të cilat kanë më pak se 50 punonjës, procedurat e prokurimit për to i kryen AQP-ja. Gjatë vitit 2016, AQP përveç këtyre prokurimeve kishte zhvilluar edhe procedura për prokurime të centralizuara.

MF duhet t'i kushtojë rëndësi me të madhe menaxhimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe për investime kapitale të cilat kalojnë përmes procesit të prokurimit, sepse kontrollet nuk ishin në nivelin e duhur.

2.2.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë dhe KA si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tetë (8) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe shtatë (7) auditor. Kjo njësi është e organizuar në dy (2) divizione, në atë për auditime brenda MF-së, si dhe divizioni për auditime jashtë MF-së, për entitetet që nuk kanë themeluar NjAB-të.

Plani vjetor i auditimit ishte gjithëpërfshirës dhe reflektonte rreziqet financiare në mënyrë që të ofroj siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Për vitin 2016, kjo njësi kishte arritur t'i finalizojë të gjitha auditimet e planifikuara, gjithsej 16. Po ashtu përveç realizimit të planit NjAB kishte kryer edhe dy (2) auditime tjera me kërkesë të menaxhmentit.

Në raportet e auditimit të brendshëm ishin dhënë gjithsej 65 rekomandime. Prej tyre 46 ishin zbatuar, ose 71%. Inkurajojmë menaxhmentin të hartojë një plan për zbatimin e plotë të tyre.

KA gjatë vitit kishte mbajtur katër (4) takime, ku ishin diskutuar rekomandimet e NjAB-së si dhe rekomandimet e raportit të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy (2), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MF në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në kontekst të sistemeve financiare, MF kishte vendos kontrolle të mira edhe të menaxhimi i subvencioneve, si dhe të menaxhimi dhe raportimi i obligimeve të pa paguara.

MF për vitin 2016 ka realizuar 78% të buxhetit final. Mirëpo nëse përjashtojmë buxhetin në vlerë prej 4 mil.€ (të cilat figurojnë në buxhetin final të MF-it por jo edhe në realizim për arsye se nuk menaxhohen nga MF-i) që janë mjete për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit, atëherë realizimi i buxhetit final është 90% që paraqet një përqindje të mirë, por se krahasuar me vitin e kaluar kemi një rënie prej 7%.

Mirëpo, përveç këtyre, edhe më tutje mbetet sfida përcjellja e disa projekteve nga viti në vit, të cilat ndikojnë në nivel të ulët të shfrytëzimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale. Mangësi kishte edhe në menaxhimin e burimeve njerëzore, fushën e prokurimit si dhe në regjistrimin e pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MF-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e grumbulluara. Këto janë të paraqitura në tabelat nr.1, nr.2 dhe nr.3.

Megjithatë, pasi që DK dhe ATK grumbullojnë mbi 90% të të hyrave të përgjithshme të Buxhetit të Kosovës, ne kemi kryer auditime të veçanta për to, dhe kemi hartuar raporte individuale të auditimit të cilat publikohen në web-faqen tonë.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore- realizimi ndaj buxhetit (në €)²

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	31,155,636	28,284,786	21,936,786	24,207,614	29,296,591
Granti i Qeverisë -Buxheti	25,258,890	22,253,491	21,479,420	23,412,058	28,508,889
Financimi nga Huamarrja	95,000	95,000	87,935	350,021	119,871
Donacionet e jashtme	342,286	476,836	369,431	445,535	667,831
Financimi i huamarrjes për klauzolë investive	5,459,459	5,459,459	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 2,870,850€. Ky reduktim ishte rezultat i ndryshimeve buxhetore nga ana e Qeverisë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike në nivel të Ministrisë (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	31,155,636	28,284,786	21,936,786	24,207,614	29,295,000
Pagat dhe Mëditjet	15,340,591	15,245,227	15,023,227	14,369,590	14,023,000
Mallrat dhe Shërbimet	5,841,585	5,501,808	5,311,572	5,890,597	7,392,000
Shërbimet komunale	428,592	348,741	316,892	342,825	401,000
Subvencionet dhe Transferet	95,858	288,757	288,757	3,103,321	2,662,000
Investimet Kapitale	9,449,010	6,900,253	996,338	501,281	4,817,000

MF, përfshirë agjencitë ekzekutive për vitin 2016 ka realizuar 78% të buxhetit final. Mirëpo nëse përjashtojmë buxhetin në vlerë prej 4 mil.€, (të cilat figurojnë në buxhetin final të MF-it por jo edhe në realizim për arsye se nuk menaxhohen nga MF-i) që janë mjetet për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit, atëherë realizimi i buxhetit final është 90%, që krahasuar me vitin e kaluar është një rënie prej 7%.

Në këtë tabelë është paraqitur buxheti dhe shpenzimet për MF-in, duke përjashtuar të dhënat për Doganën dhe ATK-në.

² Shumat në këtë tabelë janë: buxhetet dhe realizimi i MF-së së bashku me DK dhe ATK. Për DK ishin buxhetuar 7,929,481€ dhe realizuar 7,838,762€, kurse për ATK ishin buxhetuar 8,930,523€ dhe realizuar 8,834,937€.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2a. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	10,846,771	8,430,795	5,263,086	8,531,511	12,127,888
Pagat dhe Mëditjet	2,506,137	2,763,488	2,546,677	2,537,488	2,483,717
Mallrat dhe Shërbimet	2,527,489	2,382,447	2,345,981	2,780,604	3,550,734
Shërbimet komunale	126,645	40,552	35,956	47,927	52,639
Subvencionet dhe Transferet	20,000	288,757	288,757	3,103,321	2,662,000
Investimet Kapitale	5,666,500	2,955,551	45,715	62,171	3,388,446

Edhe përkundër reduktimit të buxhetit final në raport me buxhetin fillestar për 2,415,976€, realizimi i buxhetit ishte shumë i ulët në vetëm 62%.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rrit për 257,351€. Rritja ishte rezultat i bashkimit të departamenteve të buxhetit qendror dhe atij lokal në një departament. Kjo ka rezultuar më rritjen e koeficientit për drejtorin e këtij departamenti, mbulimin e pozitave të lira, si dhe pagesat e kompensimeve për komisione;
- Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte 98% e buxhetit final. Ndërsa buxheti final në raport me atë fillestar për kategorinë e shërbimeve komunale ishte reduktuar për 86,093€, të cilat janë alokuar në mallra dhe shërbime. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 89% e buxhetit final;
- Si rezultat i vendimeve të Qeverisë dhe vendimeve të ministrit të Financave, kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishte rritur për 268,757€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 100%; si dhe
- Pavarësisht reduktimit të buxhetit final për investime kapitale, realizimi i buxhetit ishte në nivel shumë të ulët. Në këtë kishte ndikuar mos realizimi i projekteve të buxhetuara. Po ashtu, në buxhetin fillestar ishte përfshirë vlera 4,000,000€ e Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit (FZHM). Këto mjete, pas miratimit të projekteve specifike nga ana e Bordit Menaxhues të këtij fondi, transferohen tek komunat përfituese. Në fund të viti fiskal vlera e mbetur, e pa transferuar ishte 444,358€. Po, ashtu Fondi (paga në mirëbesim që operon Thesari) në fund të vitit ishte 119,002€. Këto fonde nuk menaxhohen nga Thesari.

Çështja 3 – Realizimi i ulët i buxhetit te investimet kapitale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Realizimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale ishte në nivel shumë të ulët. Në këtë ka ndikuar përfshirja e FZHM në realizim të buxhetit si dhe bartja e projekteve “Zhvillimi i sistemit datawarehouse, integrimin e sistemeve të MF” dhe “Fillimi i punëve në ndërtimin objektit të ATK-DK në Prishtinë” të cilat ishin bartur si projekte nga viti i kaluar, mirëpo edhe për vitin 2016 nuk ishte realizuar asnjë pagesë.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimit i ulët i tij rrezikon në arritjen e objektivave të organizatës, po ashtu ndikon që financimi për këto projekte të mbetet barrë e buxhetit të vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë që përgatitjes së kërkesave buxhetore t’i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit si dhe të sigurojë se performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i projekteve kapitale për tu siguruar se ato përfundohen sipas afateve të kontraktuara dhe me cilësi optimale.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në vitin 2016, nga MF, përfshirë edhe agjencitë ekzekutive ishin në vlerë 1,438,177,981€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat tatimore dhe jo-tatimore. Ne audituam vetëm të hyrat e grumbulluara nga Thesari dhe Administrata Qendrore e MF-it, të cilat janë në vlerë prej €373,981 si dhe të hyrat nga donacionet në vlerë prej 265,200€. Çështjet që i përkasin të hyrave të grumbulluara nga DK dhe ATK nuk ishin pjesë e këtij auditimi. Ato janë trajtuar në raporte të veçanta të auditimit.

Tabela 3. Të hyrat e përgjithshme të grumbulluara për Buxhetin e Kosovës

Agjencitë /Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	2016 Të hyrat neto	2015 Të hyrat neto	2014 Të hyrat neto
Dogana	1,051,419,000	7,376,927	1,043,042,073	944,929,869	868,570,436
ATK	386,385,000	31,004,545	355,380,455	304,003,191	272,586,344
NjIF	12,000	0	12,000		
AQP	0	0	0	0	10,430
Thesari	282,750	0	282,750	1,468,297	201,100
Administrata Qendrore e MF-it	79,231	0	79,231	74,464	74,928
Totali	1,438,177,981	38,381,472	1,398,796,509	1,250,475,821	1,141,443,238

MF sa i përket mbledhjes dhe raportimit të të hyrave, ka vendosur një sistem efikas të kontrollit. Regjistrimi i të hyrave është bërë sipas procedurave dhe kërkesave ligjore. Janë bërë harmonizime të rregullta me raportet bankare dhe se të njëjtat janë regjistruar në SIMFK, si dhe janë klasifikuar në kode përkatëse.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollët kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e MF-së. Buxheti i ndarë për këtë kategori ishte shpenzuar 92%. Përkundër masave të marra në forcimin e kontrolleve, MF duhet të vazhdojë edhe më tutje të shtoj kontrollët për të siguruar evitimin e mbulimit të pozitive udhëheqëse me ushtrues detyre përtej afateve ligjore si dhe pagesën e stafit në pajtim me ligjin e buxhetit. Testimet tona kanë identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja 4 - Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore - Prioritet i lartë

E gjetura Testimet tona identifikuan mangësitë në vijim:

- **Mbulimi i pozitive me ushtrues detyre (U.D) për një periudhë më të gjatë se kërkesat ligjore.** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil neni 30 pika 4 "Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj".

Pozita e udhëheqësit të divizionit të politikave fiskale, vazhdon të mbulohet me U.D. që nga viti 2014, përderisa pozita e menaxherit të prokurimit mbulohet fillimisht me zëvendësim nga janari 2016 e më pas me U.D. nga korriku 2016. Këto pozita vazhdojnë të mbulohen me U.D. edhe në vitin 2017, përkatësisht deri muajin mars, në kohën sa ishim në auditimin final; dhe

- **Vazhdimi i pagesës bazuar në vendimet e më hershme.** Në dy raste edhe pas shfuqizimit të vendimeve 39/2015 respektivisht 41/2015 që i kthen zyrtarët në pozitat e mëparshme, edhe më tutje të njëjtit vazhdojnë të marrin pagën me koeficientet e vendimeve të mëhershme.

-
- Rreziku** Menaxhimi i dobët i personelit, përfshirë, mbulimin e pozitave me U.D si dhe mos harmonizimi i koeficienteve për pozitat përkatëse mund të ndikoj në mos përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive përkatëse dhe të sjellin ministrinë në vështirësi financiare.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave të caktuara me punëtorë të rregullt dhe se pagesat për paga dhe mëditje bëhen në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2016 ishte 2,422,999€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,381,937€, ose mbi 98%. Shpenzimet në këtë kategori kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për mirëmbajtje të teknologjisë informative, shërbime kontraktuese, sigurimi i ndërtesave, mirëmbajtje e automjeteve, shpenzime të anëtarësimit si dhe shpenzime tjera.

Sipas LPP-së neni 21/A, për qëllime të ekonomizimit, për agjencitë e pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat kanë më pak se 50 punonjës, procedurat për prokurime i zhvillon Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP). Ne testuam tetë (8) procedura të prokurimit nga 36 sa janë zhvilluar nga AQP-ja gjatë vitit 2016. Nga këto teste kemi konstatuar se i gjithë procesi ishte kryer në pajtim me ligjin.

Vlen të theksohet se nga zhvillimi i aktiviteteve të prokurimeve të veçanta për vitin 2016 është arritur të kursehen mjete buxhetore në vlerë prej 187,265€, pasiqë vlera e parashikuar e kontratave nga Autoritetet Kontraktuese të dërguara në AQP për zhvillimin e procedurave të prokurimit ishte 596,045€, përderisa vlera e kontratave të nënshkruara ishte 408,779€. Derisa, testet tona në prokurimin (shpenzimet e MF-së) shpalosën dobësitë e prezantuara në vijim.

Çështja 5 - Dobësi në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura

Testimet tona identifikuan mangësitë në vijim:

- Për aktivitetet e prokurimit “Shërbime të udhëtimit zyrtar me aeroplan për nevoja të MF” dhe “Furnizim me material për zyrë për nevoja të MF”, zyrtari i përcaktuar përkohësisht U.D. Menaxheri i prokurimit, ishte njëherit edhe kryesues i komisionit për vlerësimin e këtyre tenderëve;
- Sipas nenit 11 të ligjit të ATK-së, çdo person jo-rezident i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Republikën e Kosovës, në pajtim me legjislacionin tatimor të vendit, do të caktojë një përfaqësues fiskal përpara se të filloj përmbushjen e kontratës.

Thesari kishte nënshkruar dy (2) kontrata, njëra në shkurt ndërsa tjetra në prill të 2016, për shërbime të përdorimit të licencës për menaxhimin e të dhënave të SIMFK-së, mirëpo në kontrata nuk ishte specifikuar pagesa e tatimeve. Thesari nuk ka ofruar dëshmi se Operatori Ekonomik (OE) ndërkombëtar ka përfaqësues fiskal të regjistruar në Kosovë për çështje të obligimeve tatimore; dhe

- Vlera e mazhës apo çmimi i shërbimit për një biletë të cekur në dosjen e tenderit, ku janë të përfshira të gjitha obligimet tatimore ishte 0,30€, ndërsa në faturën 207 të protokolluar me 22.07.2016 ky shërbim është faturuar me 1€. Vlera e mazhës është përcaktuese për fituesin e kontratës.

Rreziku

Angazhimi i U.D Menaxherit të prokurimit në pozitën e Kryesuesit të komisionit për vlerësim të tenderëve përveç që është në kundërshtim me LMFPP, ndikon në vlerësim jo objektiv të tenderit. Gjithashtu lëshimet procedurale si dhe pagesa e tarifës më të lartë të shërbimit se ajo e kontratës ndikojnë cilësinë e shërbimeve si dhe në mbledhjen e tatimit.

Rekomandimi 5

Ministri duhet të sigurojë se përcaktimi i anëtarëve të komisioneve për vlerësim të tenderëve bëhet në pajtim me kërkesat e LPP, në mënyrë që të eliminohet mundësia për konflikt interesi. Kontratat duhet të lidhen vetëm me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara brenda kornizave ligjore. Për me tepër çmimet e paguara duhet të bazohen në çmimet e kontraktuara.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 288,757€ i cili ishte shpenzuar në tërësi. Këto mjete ishin ndarë sipas Vendimeve të Qeverisë për raste të ndryshme. Krahasuar me vitin paraprak buxheti ishte me i ulët për 2,814,564€. Ky ndryshim ishte rezultat i kalimit të pagesës së provizioneve bankare për shpërndarjen e pensioneve për përfituesit e skemës sociale nga MF-ja te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe mos subvencionimi i polisave të sigurimit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapital i MF-it ishte 2,955,551€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar vetëm 45,715€.

Shkaqet e një niveli kaq të ulët të shfrytëzimit të buxhetit për këtë kategori janë: transferi i projektit nr.11286⁴ në vlerë prej 400,000€ nga programi 13300-DK në programin 11301-Administrata Qendrore MF, bartja e projekteve nga viti i kaluar dhe mos realizimi i asnjë pagese gjatë vitit 2016, vonesa në inicimin e aktiviteteve të prokurimit, anulimi i aktiviteteve të prokurimit, kthimi në rivlerësim i tenderëve nga ana e OSHP etj.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

⁴ Fillimi i punimeve në ndërtimin e objektit ATK-DK në Prishtinë

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 6 – Nënshkrimi i kontratës nga zyrtari i prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura Sipas nenit 26 të LPP 04/L-042, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që lidh ose nënshkruan kontratë publike në emër të Autoritetit Kontraktues.

Në mungesë të licencës nga zëvendësuesi i menaxherit të prokurimit, zyrtari i prokurimit (i licencuar) ka nënshkruar kontratat për aktivitetet e prokurimit "Furnizim me server për nevojat të Thesarit-MF", "Shërbime të udhëtimit me aeroplan për nevoja të MF", si dhe "Furnizim me material për zyrë për nevoja të MF". Kjo gjendje kishte vazhduar edhe pas caktimit të U.D. Menaxherit të prokurimit.

Caktimi i menaxherit të ri të prokurimit (në pozitë si U.D) është bërë në korrik të 2016 dhe vazhdon të mbulojë ende këtë pozitë (deri në mars 2017, në kohën sa ishim në fazën finale të auditimit).

Rreziku Mos definimi i qartë i pozitës së zyrtarit përgjegjës të prokurimit e shkaktonë hallkën e llogaridhënies tek ZKA.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura dhe në kohë, për caktimin e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të posedojë të gjitha kualifikimet adekuate bazuar në përshkrimin e pozitës së punës.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurisë kapitale e MF-së dhe agjencive të saja vartëse për vitin 2016 është 6,827,861€. Për njehsimin fizik apo inventarizimin e pasurisë, MF kishte formuar dy komisione. Njërën për inventarizimin e pasurisë së Thesarit ndërsa tjetri për inventarizim të pasurisë në MF.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Obligimet

Pasqyra e obligimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit të vitit 2016 ishte 67,170€. Kjo vlerë e obligimeve kryesisht ka të bëjë me faturat për mallra dhe shërbime, të cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Raportimi ishte bërë në përputhje me rregullën për raportimin e obligimeve.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak-	Ministri duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.		Disa rekomandime nga viti i kaluar nuk janë zbatuar plotësisht. Kjo përfshinë kryesisht fushën e menaxhimit të personelit dhe prokurimit.	
2.4 Lista kontrolluese vet-vlerësuese	Ministri duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, e mbështetur me planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara. Po ashtu, të ndërmerren masa proaktive për adresimin e fushave me mangësi të theksuara të identifikuara në listën kontrolluese të vet-vlerësimit.		Gjatë vitit 2016 është formuar një grup punues i cili ka punuar në hartimin e planit strategjik zhvillimor 2016-2020 i cili edhe është aprovuar, mirëpo kostoja financiare e strategjisë ende nuk është aprovuar.	
2.5.1. Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprime konkrete për azhurnimin e vazhdueshëm të planit për menaxhimin e rrezikut, në mënyrë që të vendosen edhe masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuara.	Po		

3.5. Prokurimi	Ministri duhet të siguroj përmes Sekretarit të Përgjithshëm se janë forcuar kontrollet e brendshme rreth përpilimit të dosjes së tenderit dhe të vlerësimit të ofertave për të siguruar prokurime efektive dhe përzgjedhjen e ofertave më të mira të mundshme.	Po		
3.5. Prokurimi	Ministri duhet të siguroj se ka forcuar kontrollet ekzistuese me rastin e pranimin të mallrave dhe në sektorin e pagesave për të evituar pranimin e mallrave të pa kontraktuara dhe pagesën për shërbimet e papranuara.	Po		
3.5. Prokurimi	Ministri duhet të siguroj se ka kryer një rishikim të gjithanshëm të kësaj kontrate dhe të ndërmer veprimet e duhura që kontrata të trajtohet brenda kornizave ligjore të prokurimit.	Po		
3.6.1 Kompensimet	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave të caktuara me punëtorë të rregullt. Më tutje, duhet të siguroj se shpërndarja e personelit përbrenda institucionit është në harmoni me limitet e lejuara të të punësuarve sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit.		Shpërndarja e personelit është bërë sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit, mirëpo ende vazhdohet mbulimi i pozita me U.D.	
3.7.1. Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmer veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Zyrtarëve përgjegjës t'u ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.	Po		

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelaria e Sekretarit të Përgjithshëm			
12.05.2017			
21	21.2	517	2

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave

Ministarstvo Finasija - Ministry of Finance

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelaria e Sekretarit të Përgjithshëm - Office of General Secretary

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Financave, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
-